REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____/2026

PËR

DONACIONET DHE SPONSORIZIMET

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

1. Ky ligj synon të nxisë donacionet dhe sponsorizimet për realizimin e veprimtarive me interes publik në Republikën e Shqipërisë, si dhe të vendosë rregulla të përgjithshme për transparencën, integritetin, parandalimin e pastrimit të produkteve të veprës penale dhe luftën ndaj korrupsionit në proceset e pranimit të donacioneve dhe të sponsorizimeve.

2. Ky ligj ka si objekt përcaktimin e parimeve, rregullave dhe procedurave për mbështetjen e veprimtarive me interes publik nëpërmjet donacioneve dhe sponsorizimeve, sipas subjekteve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

3. Ligji përcakton rregullat për krijimin, administrimin, funksionimin dhe përditësimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve.

4. Ky ligj synon gjithashtu të garantojë gjurmueshmërinë e sponsorizimeve, zbatimin e rregullave për përfitimin e lehtësive tatimore dhe parandalimin e shmangies së detyrimeve ligjore.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet në realizimin e veprimtarive me interes publik në fushat e mëposhtme:

a) Shërbimet sociale dhe veprimtaritë humanitare në mbështetje të grupeve në nevojë;
b) Arti, kultura dhe mbrojtja e trashëgimisë;
c) Zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve;
ç) Shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor;
d) Mbrojtja e mjedisit dhe e klimës;
dh) Sporti, infrastruktura sportive dhe edukimi fizik;
e) Arsimi, rinia, kërkimi shkencor, inovacioni dhe transformimi digjital;
ë) Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore;
f) Demokracia, shteti i së drejtës, mirëqeverisja dhe lufta kundër korrupsionit;
g) Liria e medias;
gj) Projekte infrastrukturore publike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, përfshirë projekte që kontribuojnë në rritjen e sigurisë rrugore;
h) Fusha të tjera të veprimtarisë me interes publik, të parashikuara shprehimisht me ligj të veçantë ose nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Donacion"**, transferimi vullnetar dhe pa kundërshpërblim i mjeteve financiare, ofrimi i shërbimeve ose i formave të tjera të ligjshme të mbështetjes për realizimin e veprimtarive me interes publik. Përcaktimi i një destinacioni të ligjshëm për përdorimin e donacionit nuk përbën kundërshpërblim.

2. **"Donator"**, çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që lidh një marrëveshje donacioni, sipas rregullave të këtij ligji me një organ publik.

3. **"Konflikt interesi"** ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
4. **"Marrëveshja e sponsorizimit"**, marrëveshja e shkruar ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit të sponsorizimit, që përcakton objektin, qëllimin, formën, vlerën, kushtet e dhënies dhe përdorimit të sponsorizimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë të drejtën e promovimit të sponsorizuesit, sipas këtij ligji.

5. **“Lehtësia tatimore”**, përfitimi tatimor që i njihet sponsorizuesit, sipas kushteve dhe kufijve të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin tatimor në fuqi.

6. **“Marrëveshja e donacionit”** përcakton objektin, qëllimin, formën, vlerën, destinacionin dhe kushtet e përdorimit të donacionit, pa kundërshpërblim, në favor të donatorit, në mbështetje të veprimtarive publike, të përcaktuara në këtë ligj.

7. **“Organ publik”** ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

8. **“Organizata jofitimprurëse”**, shoqatat, fondacionet dhe qendrat, në kuptim të ligjit për organizatat jofitimprurëse, dhe që janë regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

9. **“Organizata sportive”** ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në ligjin për sportin, e cila, për efekt të këtij ligji, konsiderohet subjekt përfitues.

10. **“Përfitues i sponsorizimit”**, organi publik, organizata jofitimprurëse, organizata sportive, shoqëria sportive, subjekti tregtar në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audiovizive, botuesit e shtypit e të veprave letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe individi në fushën e kulturës, artit, sportit, në rastet kur përfaqëson Republikën e Shqipërisë në nivel ndërkombëtar, që përfiton sponsorizim, sipas këtij ligji.

11. **“Përfitues i donacionit”**, organi publik që përfiton donacion, sipas këtij ligji.

12. **“Promovim”**, komunikimi publik i emrit, logos ose shenjave të tjera dalluese të sponsorizuesit, në kuadër të veprimtarisë së sponsorizuar, me qëllim identifikimin dhe njohjen publike të kontributit të tij, pa përfshirë komunikime që synojnë drejtpërdrejt nxitjen e blerjes ose përdorimit të produkteve apo shërbimeve.

13. **“Regjistri”**, Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve.

14. **“Reklamë”**, çdo komunikim me natyrë tregtare që, pavarësisht formës ose mjetit të përdorur, synon të nxisë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, blerjen, përdorimin ose përzgjedhjen e produkteve apo shërbimeve dhe që nuk përbën promovim të sponsorizuesit, sipas pikës 12, të këtij neni.

15. **“Sponsorizim”**, mbështetja financiare, materiale ose në forma të tjera të ligjshme, që sponsorizuesi i jep vullnetarisht përfituesit të sponsorizimit, në

bazë të kontratës së sponsorizimit, për realizimin e veprimtarive me interes publik, në këmbim të së drejtës së promovimit të emrit, logos ose shenjave të tjera dalluese të tij, sipas këtij ligji.

16. **"Sponsorizues"**, çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që lidh një marrëveshje sponsorizimi, sipas rregullave të këtij ligji, me përfituesin e sponsorizimit.

17. **"Shoqëri sportive"** ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në ligjin nr.79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, e cila, për efekt të këtij ligji, konsiderohet subjekt përfitues.

18. **"Veprimtari me interes publik"**, çdo organizim, program, aktivitet, projekt, përmirësim i infrastrukturës ose i shërbimeve apo nismë tjetër e ligjshme, në fushat e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji, që synon të sjellë përfitime për publikun, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të menjëhershme ose afatgjata, pavarësisht natyrës publike ose private, formës juridike apo karakterit fitimprurës të subjektit përfitues.

19. **"Zyrtar publik"** ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 4
Subjektet e ligjit

1. Subjekte të këtij ligji janë organet publike, kur pranojnë donacione dhe sponsorizime për realizimin e veprimtarive me interes publik, sipas fushave të përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji.

2. Organet publike nuk zbatojnë rregullat e këtij ligji për donacionet, që përfitohen në kuadër të aktivitetit të institucioneve publike ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare, që kanë marrëveshje zyrtare me Republikën e Shqipërisë.

3. Rregullat e këtij ligji nuk zbatohen për pranimin e donacioneve nga organet publike, kur dispozitat e tij bien ndesh me rregullat për pranimin e donacioneve të parashikuara në ligje të posaçme.

4. Donatorët dhe sponsorizuesit respektojnë kërkesat e këtij ligji kur hyjnë në marrëdhënie me subjektet përfituese, të përcaktuara në këtë nen.

5. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në lidhjen e kontratave të sponsorizimit për realizimin e veprimtarive me interes publik, sipas fushave të përcaktuara në nenin 2, të tij, nga subjektet e mëposhtme:

   a) Organizatat jofitimprurëse;
   b) Organizatat sportive;
   c) Shoqëritë sportive;
   ç) Subjektet tregtare në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audiovizive;
   d) Individët që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare në fushën e artit, sportit, kulturës;
   dh) Botuesit e shtypit dhe të veprave letrare, shkencore, enciklopedike.

6. Sponsorizuesit respektojnë kërkesat e këtij ligji kur hyjnë në marrëdhënie me subjektet e përcaktuara në pikën 5, të këtij neni, në mbështetje të veprimtarive publike.

7. Sindikatat dhe partitë politike nuk janë subjekte të këtij ligji.

8. Përjashtimet e parashikuara në këtë nen nuk cenojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, për subjektet që përbëjnë autoritete publike, sipas këtij legjislacioni.

Neni 5
Parime të përgjithshme

1. Pranimi dhe përdorimi i donacioneve dhe sponsorizimeve bazohet në parimet e ligjshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, integritetit institucional, llogaridhënies dhe shmangies së konfliktit të interesit.

2. Pranimi dhe administrimi i donacioneve dhe sponsorizimeve kryhen duke garantuar parandalimin e korrupsionit, shmangien e konfliktit të interesave dhe respektimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Neni 6
Format e donacioneve dhe sponsorizimeve

1. Donacionet dhe sponsorizimet financiare kryhen nëpërmjet sistemit bankar, nëpërmjet transfertës së fondeve, nga llogaria bankare e dhënësit në llogarinë bankare të përfituesit. Kryerja e donacioneve dhe sponsorizimeve financiare në para fizike (*cash*) nuk lejohet.

2. Donacionet dhe sponsorizimet në pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, mallra, mbështetje në infrastrukturë dhe ofrim shërbimesh llogariten me vlerën e tregut në momentin e dhënies së donacionit ose në momentin e lidhjes së kontratës së sponsorizimit. Kur mbështetja përfshin forma të kombinuara, çdo element identifikohet dhe vlerësohet veçmas.

3. Ekspertiza teknike ose profesionale, e ofruar pa kundërshpërblim, evidentohet sipas natyrës, objektit dhe kohëzgjatjes së saj. Donacionet në formën e ekspertizës teknike ose profesionale nuk konvertohen në vlerë financiare.

4. Donacionet ose sponsorizimet për projekte infrastrukturore publike mund të jepen në formë financiare ose në formën e projekteve zhvillimore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rast se donacioni ose sponsorizimi jepet në formën e një projekti zhvillimor, donatori ose sponsori, së bashku me paraqitjen e projektidesë, mund të kërkojë që, në rast të miratimit dhe zbatimit të saj, të kryejë verifikimin e përputhshmërisë ndërmjet projektit të zbatimit dhe projektidesë, nëpërmjet hartimit të oponencës përkatëse. Në rastin e donacioneve ose sponsorizimeve të dhëna në formën e projekteve zhvillimore, vlera e tyre përcaktohet mbi bazën e kostos së projektimit ose të zbatimit të projektit, sipas dokumentacionit teknik dhe financiar përkatës, dhe vlerësohet nga institucioni publik përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Rregullat dhe metodologjia për vlerësimin e projekteve zhvillimore të infrastrukturës publike, që përbëjnë donacion ose sponsorizim, si dhe kriteret dhe mënyra e përcaktimit të tarifës për kryerjen e oponencës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Kufizime për donatorët dhe sponsorizuesit

1. Personi fizik ose juridik, i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra të lidhura me korrupsionin aktiv ose pasiv, të parashikuara në Kodin Penal, pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, financimin e terrorizmit, vepra me qëllime terroriste, trafikimin e paligjshëm, fshehje e të ardhurave, mospagimin e detyrimeve tatimore dhe doganore, falsifikimin e dokumenteve, si dhe personi fizik ose juridik, ndaj të cilit zbatohet masa shtrënguese ndërkombëtare, masa për ngrirjen e fondeve ose pasurive, nuk mund të jetë donator ose sponsorizues. Nuk mund të jetë donator ose sponsorizues edhe personi fizik ose juridik ndaj të cilit zbatohen masa shtrënguese ndërkombëtare, masa për ngrirjen e fondeve ose pasurive, apo që rezulton i përfshirë në listat e personave, subjekt të këtyre masave. Ky ndalim zbatohet edhe kur personi i dënuar ose personi, ndaj të cilit zbatohen masat e

sipërpërmendura, është pronar përfitues, aksionar, ortak ose administrator i personit juridik.

2. Personi juridik, që është objekt procedure falimentimi ose likuidimi, ka asete të administruara nga gjykata ose nga administrator falimentimi, ka pezulluar veprimtarinë tregtare ose ka lidhur marrëveshje me kreditorët për shlyerje të borxheve, sipas legjislacionit në fuqi për falimentimin, nuk mund të jetë donator dhe sponsorizues.

3. Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtari prodhimi, importi, eksporti, ose reklamim të produkteve të duhanit dhe pijeve alkoolike, nuk mund të jetë donator ose sponsorizues i organeve publike.

4. Personi fizik ose juridik që reklamon lojërat e fatit nuk mund të jetë donator ose sponsorizues i organeve publike.

5. Zyrtari publik nuk mund të jetë donator në organin publik ku ushtron detyrat, në organe të tjera në varësi ose nën mbikëqyrjen e këtij organi. Të njëjtin ndalim e ka bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmija madhor i zyrtarit publik.

6. Subjektet buxhetore dhe shoqëritë, ku shteti zotëron aksione, nuk mund të jenë sponsorizues.

7. Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtari prodhimi, importi, eksporti, shpërndarjeje apo reklamimi të duhanit dhe pijeve alkoolike, i ndalohet reklamimi i produkteve të duhanit dhe pijeve alkoolike, në rast se kryen sponsorizim për subjektet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të këtij ligji.

8. Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtari në fushën e lojërave të fatit apo të reklamimit të tyre, i ndalohet reklamimi i lojërave të fatit apo çdo logo e lidhur me lojërat e fatit, në rastin kur është sponsorizues për subjektet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të këtij ligji, për aq sa nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

9. Donacionet dhe sponsorizimet anonime janë të ndaluara.

Neni 8
Kontrata e sponsorizimit

1. Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit të sponsorizimit.

2. Kontrata e sponsorizimit përmban të paktën:

a) palët kontraktuese;
b) objektin dhe qëllimin e sponsorizimit;
c) formën dhe vlerën e sponsorizimit;
ç) kohëzgjatjen;
d) destinacionin dhe mënyrën e përdorimit të sponsorizimit;
dh) mënyrën dhe kufijtë e promovimit të sponsorizuesit;
e) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
ë) detyrimet për dokumentimin dhe raportimin;
f) kushtet për ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratës.

3. Elementet e tjera të kontratës përcaktohen sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

4. Kontrata e sponsorizimit mund të lidhet për një periudhë të caktuar ose të shtrihet në më shumë se një vit fiskal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve. Përfitimi i lehtësive tatimore lidhet me vlerën e sponsorizimit të realizuar dhe të dokumentuar gjatë vitit fiskal përkatës, sipas legjislacionit tatimor.

Neni 9
Dokumentacioni dhe verifikimi

1. Sponsorizuesi dorëzon pranë përfituesit të sponsorizimit dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e identifikimit ose ekstraktin historik për personin juridik, si dhe ekstraktin nga Regjistri i Pronarëve Përfitues;
b) Vërtetimin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për:

i. personin fizik;
ii. personin juridik;
iii. administratorin e personit juridik;
iv. aksionarët ose ortakët e personit juridik;
v. pronarët përfitues të personit juridik.

c) Për personin fizik, vërtetim nga administrata tatimore që nuk ka detyrime, nëse është subjekt deklarimi, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, si dhe vërtetim nga administrata doganore që nuk ka detyrime, nëse është subjekt i detyrimeve doganore, sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë;
ç) Vërtetim nga administrata tatimore dhe administrata doganore për personin juridik që nuk ka detyrime të pashlyera, nëse është subjekt i këtyre detyrimeve, sipas legjislacionit tatimor në Republikën e Shqipërisë;

d) Deklaratë me shkrim nga personi fizik se nuk është dënuar në shtete të tjera për korrupsion aktiv ose pasiv, pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, financim të terrorizmit, trafikim të paligjshëm, fshehje e të ardhurave, mospagim të detyrimeve tatimore dhe doganore, falsifikim dokumentesh;

dh) Deklaratë me shkrim nga administratori dhe aksionari ose ortaku i personit juridik dhe pronari përfitues se nuk është dënuar në shtete të tjera për vepra të lidhura me korrupsionin aktiv ose pasiv, pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, financimin e terrorizmit, trafikimin e paligjshëm, fshehjen e të ardhurave, mospagimin e detyrimeve tatimore dhe doganore, falsifikimin e dokumenteve;

e) Vërtetim se janë përmbushur të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nëse është subjekt i këtyre detyrimeve në Republikën e Shqipërisë;

ë) Vetëdeklarim se sponsorizuesi nuk është në një situatë ose rrethanë të konfliktit të interesit me përfituesin;

f) Deklaratë me shkrim nëse sponsorizuesi vepron në emër ose për llogari të një personi tjetër dhe, në këtë rast, të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e personit, në emër ose për llogari të të cilit vepron.

2. Për sponsorizimet në favor të organizatave jofitimprurëse, kur vlera e përgjithshme e dhënë nga i njëjti sponsorizues për të njëjtin përfitues gjatë një viti kalendarik nuk tejkalon 300 000 (treqind mijë) lekë, paraqitet dokumenti i identifikimit ose i regjistrimit dhe vetëdeklarimi për përmbushjen e kushteve, të parashikuara në nenin 7, të këtij ligji, dhe mungesën e konfliktit të interesave me përfituesin. Autoritetet kompetente, në ushtrim të kompetencave të tyre ligjore, verifikojnë saktësinë e të dhënave të deklaruara dhe, për këtë qëllim, mund t'i kërkojnë sponsorizuesit dokumentacionin që provon vërtetësinë e tyre.

3. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, paraqitet në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Dokumentet e gjeneruara nga sistemet elektronike të institucioneve publike pranohen kur janë të pajisura me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

4. Kur përfituesi është organ publik, të dhënat dhe dokumentet që administrohen nga institucione publike sigurohen, për aq sa është e mundur, nëpërmjet ndërveprimit elektronik ndërmjet sistemeve shtetërore ose burimeve të tjera zyrtare të informacionit që disponohen nga administrata publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dokumentet që mund të sigurohen në këtë mënyrë nuk kërkohen nga donatori ose sponsorizuesi.

5. Kur të dhënat ose dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin nuk mund të sigurohen sipas pikës 4, të këtij neni, organi publik ia kërkon ato donatorit ose sponsorizuesit.

6. Afatet, procedura e paraqitjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit, mënyra e verifikimit dhe komunikimit ndërmjet palëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10
Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve

1. Krijohet baza e të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve" (në vijim Regjistri). Institucioni administrues i Regjistrit është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Regjistri krijohet, administrohet, funksionon dhe ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, qeverisjen elektronike, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Dhënës të informacionit në Regjistër janë:

   a) organet publike përfituese të sponsorizimeve;
   b) organizatat jofitimprurëse;
   c) organizatat sportive dhe shoqëritë sportive;
   ç) subjektet tregtare përfituese të sponsorizimeve, sipas këtij ligji;
   d) individët përfitues të sponsorizimeve;
   dh) institucionet publike që administrojnë bazat e të dhënave shtetërore, nga të cilat sigurohen të dhëna nëpërmjet ndërveprimit elektronik.

3. Për qëllime të këtij ligji, të dhëna parësore të Regjistrit janë:

   a) numri unik i identifikimit të regjistrimit në Regjistër;
   b) objekti dhe qëllimi i sponsorizimit;
   c) lloji dhe vlera e sponsorizimit;
   ç) data e lidhjes dhe afati i kontratës së sponsorizimit;
   d) cilësia e personit që nënshkruan kontratën e sponsorizimit, për aq sa këto të dhëna nuk sigurohen nëpërmjet ndërveprimit;
   dh) qëllimi dhe mënyra e përdorimit të sponsorizimit;
   e) raporti për realizimin e sponsorizimit;
   ë) të dhëna të tjera që lidhen drejtpërdrejt me deklarimin, regjistrimin dhe raportimin e sponsorizimit, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 13, të këtij neni.

4. Të dhënat dytësore të Regjistrit dhe bazat e të dhënave shtetërore, nga të cilat ato sigurohen nëpërmjet ndërveprimit, janë nga:

   a) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, të dhënat e identifikimit dhe të shtetësisë së individit;
   b) Regjistri Tregtar, të dhënat për emërtimin, numrin unik të identifikimit, formën juridike, selinë, adresën, administratorët, ortakët ose aksionarët e personit juridik;
   c) Regjistri i Pronarëve Përfitues, të dhënat për pronarin përfitues, sipas legjislacionit në fuqi;
   ç) regjistrat e administratës tatimore dhe doganore, të dhënat për detyrimet tatimore dhe doganore;
   d) sistemet elektronike të institucioneve përgjegjëse, të dhënat për gjendjen gjyqësore dhe përmbushjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të dhënat dytësore sigurohen, për aq sa është teknikisht dhe ligjërisht e mundur, nëpërmjet ndërveprimit të Regjistrit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore. Subjekte përgjegjëse për dhënien e këtyre të dhënave janë institucionet që administrojnë bazat përkatëse të të dhënave. Të dhënat që mund të sigurohen nëpërmjet ndërveprimit elektronik nuk kërkohen nga subjektet deklaruese.

6. Të gjitha sponsorizimet, pavarësisht vlerës së tyre, regjistrohen në Regjistër.

7. Deklarimi dhe regjistrimi i të dhënave kryhen nëpërmjet shërbimit elektronik të posaçëm në portalin qeveritar "*e-Albania*". Të dhënat e deklaruara transmetohen, administrohen dhe ruhen në Regjistër, i cili është sistemi elektronik fundor.

8. Sponsorizimet regjistrohen nga përfituesit brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së sponsorizimit.

9. Organi publik, me urdhër të titullarit, cakton nëpunësin e autorizuar për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistër. Për subjektet e tjera përfituese, përgjegjësia për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave përcaktohet me vendim të administratorit ose të organit më të lartë drejtues. Individët përfitues i regjistrojnë dhe i përditësojnë vetë të dhënat që lidhen me sponsorizimin e përfituar.

10. Publikimi dhe aksesi në të dhënat e Regjistrit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin konfidencial. Publikimi i të dhënave për

sponsorizimet bëhet në masën e nevojshme për garantimin e transparencës, pa cenuar të drejtat dhe interesat e mbrojtura me ligj.

11. Të dhënat për sponsorizimet e përfituara nga subjektet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të këtij ligji, nuk janë të aksesueshme për publikun. Organet ligjzbatuese dhe agjencitë e inteligjencës kanë akses në të dhënat e Regjistrit, sipas kompetencave dhe niveleve të aksesit, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

12. Të dhënat e publikuara për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje ose të trafikimit të qenieve njerëzore anonimizohen, duke garantuar konfidencialitetin e vendndodhjes, të përfituesve dhe të infrastrukturës mbështetëse. Ky kufizim nuk cenon aksesin e autoriteteve kompetente, sipas pikës 11, të këtij neni.

13. Rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe administrimin e Regjistrit, të dhënat parësore dhe dytësore, dhënësit e informacionit, bazat e të dhënave shtetërore me të cilat ndërvepron, mënyrën e ndërveprimit, procedurën e deklarimit dhe regjistrimit, nivelet e aksesit, si dhe procedurat për përditësimin, korrigjimin, ruajtjen dhe publikimin e të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 11
Ndryshimi i destinacionit të donacionit dhe të sponsorizimit

1. Përdorimi i donacionit dhe sponsorizimit nga organet publike bëhet vetëm për qëllime të deklaruara dhe nuk lejohet ndryshimi i destinacionit fillestar ose përdorimi për qëllime të tjera, pa ndryshuar më parë kontratën e sponsorizimit ose marrëveshjen e donacionit.

2. Organi publik duhet të bëjë përditësimin e të dhënave në Regjistër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ndryshimi i kontratës së sponsorizimit.

3. Sponsorizimi i subjekteve të parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me qëllimet e vendosura qartë në kontratën e sponsorizimit. Ndryshimi i destinacionit fillestar bëhet duke ndryshuar kontratën e sponsorizimit. Organizata jofitimprurëse, subjektet tregtare, shoqëritë sportive dhe individët duhet të bëjnë përditësimin e të dhënave në Regjistër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ndryshimi i kontratës së sponsorizimit.

Neni 12
Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat personale të donatorëve, sponsorizuesve, përfituesve dhe çdo subjekti tjetër të të dhënave, që mblidhen dhe përpunohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë në kuadër të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13
Shmangia e konfliktit të interesave në sponsorizime

1. Përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit, organi publik verifikon ekzistencën e konfliktit të interesit dhe garanton shmangien e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike. Çdo kontratë sponsorizimi, e lidhur nga organi publik në kushtet e konfliktit të interesave, është absolutisht e pavlefshme në referim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.

2. Subjektet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të këtj ligji, dhe drejtuesit, anëtarët e organeve drejtuese ose administratorët e tyre janë të detyruar të deklarojnë me shkrim përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit se nuk kanë interesa personale dhe familjare që lidhen me sponsorizuesin.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nuk mund të lidhin kontrata sponsorizimi me persona fizikë dhe juridikë, ku personat e lidhur me ta bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, të afërmit deri në shkallë të dytë kanë aksione, pjesë në kapital, janë administratorë ose anëtarë të organit drejtues.

4. Sponsorizuesit që kanë lidhur kontrata, në kundërshtim me parashikimet e këtij neni, nuk përfitojnë nga lehtësirat tatimore të njohura nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 14
Lehtësitë tatimore

1. Për subjektet, persona fizikë ose entitete, që paguajnë tatim mbi fitimin, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, shumat e sponsorizuara njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën:

a) 5 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet në favor të botuesve të shtypit dhe botimeve shkencore, enciklopedike, si dhe për sponsorizimin e aktiviteteve për kërkim dhe zhvillim, të cilat ndërmerren me qëllim përfitimin e njohurive të reja për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose në shërbime;
b) 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në shkronjën "a", të kësaj pike.

2. Dispozitat e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohen për sponsorizimet në fushat e artit, kulturës dhe sportit, për të cilat zbatohen rregullat e posaçme të parashikuara në nenin 15, të këtij ligji.

3. Sponsorizuesi dorëzon pranë organit përgjegjës kopje të kontratës së sponsorizimit, raportin për përdorimin e sponsorizimit dhe dokumente të tjera provuese, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4. Të ardhurat e përfituara nga sponsorizimi, në përputhje me këtë ligj, janë të ardhura të patatueshme për përfituesin e sponsorizimit.

5. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurat për zbatimin e këtij neni.

Neni 15
Lehtësitë tatimore në fushën e artit, sportit dhe kulturës

1. Sponsorizuesve të veprimtarive publike në fushat e artit, kulturës dhe sportit, të cilët kanë detyrim për pagesën e tatimit mbi fitimin, shuma e sponsorizuar dhe e dokumentuar u zbritet deri në masën 30 (tridhjetë) për qind të tatimfitimit, të vitit paraardhës fiskal. Zbritja zbatohet ndaj detyrimit tatimor të vitit, në të cilin realizohet sponsorizimi.

2. Në rastin e sponsorizimeve në natyrë, zbritja e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, zbatohet mbi bazën e vlerës së dokumentuar të mallrave ose shërbimeve të dhëna si sponsorizim, brenda të njëjtit kufi.

3. Shuma maksimale vjetore e sponsorizimeve për një sponsorizues, për të cilat zbatohet zbritja, sipas këtij neni, është 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë. Vlera totale vjetore e sponsorizimeve, që përfshihen në këtë mekanizëm, nuk mund të tejkalojë 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë. Ministria përgjegjëse publikon në faqen e saj zyrtare, në fund të çdo muaji, vlerën kumulative të kontratave të sponsorizimit, për të cilat është lëshuar vërtetimi.

4. Kur vlera totale e sponsorizimeve arrin kufirin e përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, përpara përfundimit të vitit, ministria përgjegjëse bën njoftim publik dhe

nuk lëshon më vërtetime për sponsorizimet, që përfshihen në këtë mekanizëm gjatë vitit përkatës.

5. Zbritja e parashikuar në këtë nen zbatohet vetëm për sponsorizimet e kryera gjatë periudhës tatimore, për të cilat është lëshuar vërtetimi i ministrisë përgjegjëse dhe, përpara realizimit të sponsorizimit, autorizimi përkatës nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Shumat e papërdorura nuk mbarten në periudhat tatimore pasuese. Shumat e sponsorizuara deklarohen veçmas në deklaratën vjetore tatimore të sponsorizuesit. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për artin, kulturën dhe sportin miratojnë udhëzimin për procedurat për zbatimin e këtij neni.

6. Të ardhurat e përfituara nga sponsorizimi përjashtohen nga tatimi. Përjashtimisht, çdo vlerë që shpenzohet nga fondet e sponsorizimit për pagesën e shpërblimeve ose honorareve është subjekt i tatimit në burim. Subjekti përfitues i sponsorizimit detyrohet të paguajë këtë tatim, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

7. Shumat e sponsorizuara të veprimtarive publike në fushat e artit, kulturës dhe sportit, për të cilat zbatohet lehtësia tatimore e parashikuar në këtë nen, përfshirë pjesën që tejkalon kufijtë e përcaktuar, nuk njihen si shpenzime të zbritshme, për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm.

Neni 16
Ankimi ndaj refuzimit të lehtësive tatimore

Sponsorizuesi ka të drejtë të ankimojë vendimin e organit tatimor për refuzimin e lehtësive tatimore, të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndaj çdo vendimi tjetër të administratës tatimore, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore.

Neni 17
Kontrolli financiar

1. Të gjitha donacionet dhe sponsorizimet i nënshtrohen kontrollit financiar dhe auditimit të jashtëm publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Organet tatimore kanë të drejtë të kryejnë, në çdo kohë, të gjitha verifikimet dhe kontrollet e nevojshme për të siguruar ligjshmërinë e donacioneve dhe sponsorizimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin, që mbahet nga organet publike, në kuadër të procedurave të pranimit të donacionit ose sponsorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin, që mbahet nga organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive, shoqëritë sportive dhe subjektet tregtare, në kuadër të procedurave të pranimit të sponsorizimit, si dhe në dokumentacionin që mbahet nga ministria përgjegjëse për artin, sportin dhe kulturën për individët përfitues të sponsorizimeve.

4. Organet publike mbajnë të dhëna dhe dokumentacion të plotë për çdo donacion dhe sponsorizim të pranuar, pavarësisht vlerës së tij. Organet publike dhe subjektet e përmendura në pikën 3, të këtij neni, ruajnë të dhënat dhe dokumentacionin përkatës që administrojnë për të paktën 5 vjet nga përfundimi i zbatimit të kontratës së sponsorizimit ose marrëveshjes së donacionit apo, kur nuk lidhet marrëveshje me shkrim, nga përfundimi i përdorimit të donacionit. Për organet publike, administrimi, ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit kryhen në përputhje me ligjin për arkivat dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 18
Interesi publik në fushën e artit, sportit dhe kulturës

1. Përpara lidhjes së kontratës së sponsorizimit, ministria përgjegjëse për artin, kulturën dhe sportin, me kërkesë të përfituesit të sponsorizimit, lëshon një vërtetim, me anë të të cilit konfirmon se veprimtaria, objekt sponsorizimi, zhvillohet në fushën e artit, kulturës ose sportit dhe përbën veprimtari me interes publik, sipas këtij ligji. Vërtetimi lëshohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së plotë dhe i përcillet kërkuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vërtetimi nuk përbën vendim për përfitimin e lehtësive tatimore, të parashikuara në nenin 15, të këtij ligji.
2. Procedura për dorëzimin e kërkesës dhe për lëshimin e vërtetimit rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin, sportin dhe kulturën.

Neni 19
Raportimi për realizimin e sponsorizimit

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të kontratës së sponsorizimit, sponsorizuesit dhe përfituesit e sponsorizimit përgatisin një raport të përbashkët për zbatimin e kontratës dhe përdorimin e sponsorizimit, të cilin e hedhin në Regjistër.

2. Përveç detyrimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, individët që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare në fushën e artit, sportit dhe kulturës dorëzojnë një kopje të raportit dhe dokumentet e kërkuara, sipas nenit 9, të këtij ligji, pranë ministrisë përgjegjëse për artin, sportin dhe kulturën.

3. Formati i raportit, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe elementet e tij përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin, sportin dhe kulturën.

KREU II
RREGULLAT E TRANSPARENCËS DHE INTEGRITETIT NË ORGANET PUBLIKE

Neni 20
Kufizime për organet publike

1. Organet e sistemit të drejtësisë, Policia e Shtetit, organet që kanë kompetenca kontrolli dhe mbikëqyrëse në fushën e prokurimit publik, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale apo luftës ndaj korrupsionit nuk mund të pranojnë donacione dhe sponsorizime, nëse nuk i lejohet shprehimisht me ligj të posaçëm. Në rastet e lejuara, për këto donacione dhe sponsorizime garantohet zbatimi i rregullave të transparencës, integritetit dhe kontrollit financiar, të parashikuara në këtë ligj.

2. Organet publike nuk duhet të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mbledhjen e donacioneve, që synojnë mbështetjen e shërbimeve të drejtpërdrejta të ofruara nga shteti pa pagesë.

Neni 21
Qasja në informacion

1. Marrëveshja e sponsorizimit, e lidhur me një organ publik, përbën informacion publik sipas ligjit për të drejtën e informimit. Organi publik publikon në faqen e tij zyrtare, në një rubrikë të dedikuar, si pjesë e programit të transparencës, kontratën e sponsorizimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i saj, duke garantuar respektimin e përcaktimeve të nenit 12, të këtij ligji. Klauzolat kontraktore të konfidencialitetit nuk mund të përdoren për të kufizuar detyrimin e publikimit, sipas këtij neni.

2. Organi publik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të kontratës të sponsorizimit, përgatit një raport për zbatimin e kontratës dhe përdorimin e sponsorizimit. Ky raport përbën dokument publik, sipas ligjit për të drejtën e informimit, dhe bëhet publik sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni.

3. Publikimi, sipas këtij neni, nuk kufizon të drejtën e aksesit në dokumente të tjera që përbëjnë informacion publik, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 22
Sponsorizimet nga persona fizikë ose juridikë të huaj

1. Organi publik, përpara nënshkrimit të kontratës së sponsorizimit, kur sponsorizuesi është person fizik ose juridik i regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, merr autorizimin me shkrim të organit epror për lidhjen e kontratës me sponsorizuesin e huaj. Nëse organi publik nuk ka organ epror dhe titullari ka autorizuar një nëpunës tjetër për nënshkrimin e kontratave, nëpunësi i autorizuar merr konfirmimin me shkrim të titullarit të institucionit për nënshkrimin e kontratës në këtë rast.

2. Organi epror ose titullari i institucionit shprehet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës për autorizim ose konfirmim. Në rast se organi epror nuk shprehet brenda këtij afati, kërkesa konsiderohet e refuzuar.

3. Organi epror ose titullari i institucionit, përpara dhënies së autorizimit ose konfirmimit, sipas pikës 1, të këtij neni, vlerëson dokumentacionin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, dhe, kur është e nevojshme, informacionin e marrë nga autoritetet kompetente, për të verifikuar se sponsorizimi nuk cenon sigurinë kombëtare, pavarësinë dhe paanshmërinë në vendimmarrje, si dhe integritetin institucional.

4. Sponsorizuesit e huaj, pavarësisht nëse kanë ose jo seli, degë ose përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, dorëzojnë dokumentacionin e parashikuar në nenin 9, të këtij ligji, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për verifikimin e statusit juridik dhe të burimit të sponsorizimit.

5. Rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit të sponsorizimeve nga sponsorizuesit e huaj, si dhe dokumentacioni plotësues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23
Thirrja e hapur për sponsorizime

1. Organet publike publikojnë në faqet e tyre zyrtare thirrjen e hapur për sponsorizim.

2. Thirrja për sponsorizim përmban të dhëna të qarta për natyrën e veprimtarisë publike që synohet të organizohet, kohëzgjatjen, grupet që ndikohen nga veprimtaria publike, natyrën e aktiviteteve ose organizimeve publike, shkallën e vizibilitetit dhe përdorimin e logos dhe të emrit të subjekteve private.

3. Thirrja për sponsorizim përmban kriteret për përzgjedhjen e sponsorizuesve, të cilat duhet të jenë objektive, transparente, jodiskriminuese, proporcionale me objektin e thirrjes dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Organet publike duhet të garantojnë se sponsorizimi nuk shkel rregullat e konkurrencës në treg.

4. Veprimtaritë me interes publik mund të sponsorizohen nga më shumë se një sponsorizues.

5. Shkalla e promovimit të emrit, logos ose shenjave të tjera dalluese të sponsorizuesit përcaktohet në kontratën e sponsorizimit dhe duhet të jetë proporcionale me vlerën dhe natyrën e kontributit. Promovimi nuk përfshin reklamimin e produkteve ose shërbimeve të sponsorizuesit.

Neni 24
Donacionet në organet publike

1. Para pranimit të donacionit, organi publik verifikon ekzistencën e çdo konflikti interesi, duke përfshirë lidhjet personale, familjare, ekonomike ose institucionale ndërmjet donatorit dhe personave të përfshirë në procesin vendimmarrës. Personat që ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit nuk marrin pjesë në shqyrtimin, miratimin, lidhjen, administrimin ose kontrollin e marrëveshjes së donacionit. Donacioni nuk pranohet kur konflikti i interesit nuk mund të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme ose kur pranimi i tij mund të cenojë paanshmërinë dhe integritetin institucional të organit publik.

2. Donacionet financiare, me vlerë të barabartë ose më të madhe se 300 000 (treqind mijë) lekë, ose që arrijnë në mënyrë kumulative këtë vlerë nga i njëjti donator, brenda një viti kalendarik, formalizohen me marrëveshje të shkruar ndërmjet organit publik dhe donatorit.

3. Organi publik verifikon që donatori nuk ndodhet në kushtet ndaluese, të parashikuara në nenin 7, të këtij ligji.

4. Organi publik publikon informacion për të gjitha donacionet e pranuara, pavarësisht vlerës së tyre, në një rubrikë të posaçme të Programit të Transparencës në faqen e tij zyrtare, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit. Informacioni përfshin të paktën emrin e donatorit, objektin dhe vlerën e donacionit, datën e pranimit dhe përdorimin e synuar të tij.

5. Donacionet në formën e mallrave, pasurive, infrastrukturës ose shërbimeve evidentohen sipas vlerës së tregut në momentin e pranimit të tyre, në përputhje me dokumentacionin shoqërues përkatës.

6. Përpara pranimit të donacionit nga një person fizik ose juridik i huaj, organi publik kërkon miratimin e organit epror dhe i vë në dispozicion informacionin e nevojshëm për verifikimin e donacionit.

7. Në procesin e pranimit të donacionit dhe të lidhjes së marrëveshjes, sipas pikës 2, të këtij neni, organet publike marrin të gjitha masat e nevojshme për garantimin e sigurisë kombëtare, pavarësisë dhe paanshmërisë në vendimmarrje, si dhe të integritetit institucional.

8. Për donacionet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, informacioni i përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, publikohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lidhja e marrëveshjes. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përdorimi i plotë i donacionit, organi publik publikon gjithashtu marrëveshjen e donacionit dhe informacionin për përdorimin e tij. Publikimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

9. Për donacionet e refuzuara, organi publik përgatit një raport vjetor që përmban arsyet e refuzimit. Raporti publikohet në faqen zyrtare të internetit të organit publik.

10. Rregullat e hollësishme për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të brendshëm të donacioneve, mënyrën e evidentimit, publikimit dhe raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25
Rregullat e brendshme të etikës dhe planet e integritetit

Organet publike, të cilat në rregulloret e brendshme dhe planet e miratuara të integritetit nuk kanë parashikime për rregullat e etikës dhe parandalimin e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe për ruajtjen e integritetit institucional në proceset e pranimit të donacioneve dhe sponsorizimeve, përditësojnë këto akte brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU III
SANKSIONE

Neni 26
Masat disiplinore për nëpunësit e organeve publike

1. Fshehja e të dhënave në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve ose deklarimi i pasaktë i sponsorizimeve nga organi publik klasifikohet si shkelje e rëndë disiplinore për nëpunësin e autorizuar për regjistrimin e të dhënave, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës.

2. Regjistrimi i të dhënave jashtë afateve, të parashikuara në nenet 10 dhe 11, të këtij ligji, nga organi publik, klasifikohet si shkelje e lehtë disiplinore për nëpunësin e autorizuar për regjistrimin e të dhënave, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës.

3. Pranimi i donacioneve dhe sponsorizimeve, në kundërshtim me nenin 7, të këtij ligji, klasifikohet si shkelje e rëndë disiplinore për titullarin e organit publik ose personin e autorizuar për lidhjen e kontratës, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës.

4. Ushtrimi i ndikimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mbledhjen e donacioneve, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 20, të këtij ligji, përbën shkelje të rëndë disiplinore për titullarin e organit publik ose nëpunësin që ka ushtruar apo ka urdhëruar këtë ndikim, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës.

Neni 27
Sanksione administrative

1. Mospublikimi nga organi publik i informacionit për donacionet e pranuara i marrëveshjes së donacionit ose i informacionit për përdorimin e tij, sipas detyrimeve të përcaktuara në pikat 4 dhe 8, të nenit 24, të këtij ligji, si dhe mospublikimi i kontratës së sponsorizimit ose i raportit për zbatimin e saj, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 21, të këtij ligji, përbën shkelje të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe dënohet me sanksionet administrative, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

2. Mospërmbushja e detyrimeve, të parashikuara në nenet 10 dhe 11, të këtij ligji, dënohet sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

3. Për sponsorizimet e pranuara, në kundërshtim me nenin 7, të këtij ligji, ose për të cilat është konstatuar një nga shkeljet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, sponsorizuesi nuk përfiton lehtësirat tatimore të parashikuara nga ky ligj.

Neni 28
Ankimi i sanksioneve administrative

Sanksionet administrative, të përcaktuara në nenin 27, të këtij ligji, ankimohen në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, të parashikuara në pikën 5, të nenit 6, dhe në pikën 6, të nenit 9, si dhe, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, të parashikuara në pikën 13, të nenit 10, në pikën 5 të nenit 22, dhe në pikën 10, të nenit 24, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për artin, sportin dhe kulturën që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë udhëzimet e parashikuara në pikën 2, të nenit 18, dhe në pikën 3, të nenit 19, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë udhëzimin e parashikuar në pikën 5, të nenit 14, të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për artin, kulturën dhe sportin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë udhëzimin e parashikuar në pikën 5, të nenit 15, të këtij ligji.

Neni 30
Dispozita kalimtare

1. Kontratat e sponsorizimit dhe procedurat e filluara për përfitimin e lehtësive tatimore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas legjislacionit në fuqi në datën e lidhjes së kontratës.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në cilësinë e institucionit administrues, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, merr masat për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit dhe të shërbimit elektronik përkatës, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Deri në vënien në funksion të Regjistrit dhe të shërbimit elektronik përkatës, përfituesit deklarojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dhënat për sponsorizimet, sipas formularit dhe mënyrës së përcaktuar dhe të publikuar prej saj.

4. Të dhënat e deklaruara, sipas pikës 4, të këtij neni, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në një evidencë të përkohshme dhe transferohen në Regjistër brenda 90 ditëve nga data e vënies së tij në funksion. Subjektet deklaruese nuk janë të detyruara të riparaqesin të dhënat dhe dokumentacionin e deklaruar gjatë periudhës kalimtare.

5. Data e vënies në funksion të Regjistrit dhe data e vënies në funksion të shërbimit elektronik përkatës publikohen në faqet zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe ministrisë përgjegjëse për artin, kulturën dhe sportin.

6. Detyrimet për deklarimin dhe regjistrimin elektronik të të dhënave nëpërmjet shërbimit elektronik të posaçëm zbatohen nga data e vënies së tij në funksion. Deri në këtë datë, përmbushja e detyrimit, sipas pikës 4, të këtij neni, konsiderohet përmbushje e rregullt e detyrimit për deklarim dhe regjistrim, sipas këtij ligji. Sanksionet për mosregjistrimin elektronik nuk zbatohen për periudhën gjatë së cilës shërbimi elektronik nuk është funksional.

Neni 31
Dispozita të fundit

1. Ligji nr.7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

   a) Shkronja “g”, e nenit 11, shfuqizohet;
   b) Pika 1/1, e nenit 40, shfuqizohet;
   c) Shkronja “p”, e pikës 1, të nenit 50, ndryshohet, si më poshtë vijon:

      “p) shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë kufijtë e parashikuar në legjislacionin në fuqi për donacionet dhe sponsorizimet.”.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DONACIONET DHE SPONSORIZIMET"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Administratës Publike dhe të ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për donacionet dhe sponsorizimet", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ALBANA KOÇIU

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

ADEA PIRDENI

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA